

PROCESVERBAL 12/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 7 (shtatë) për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 12.07.2022 duke filluar nga ora 14:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës;
3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën Janar-Qershor 2022;
5. Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi z. Denis Sofra.

Kryesuesi - i njoftoi me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikë 1

Aprovohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth kësaj pike.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e hap debatin për këtë pikë dhe për sqarime shtesë ia jep fjalë zyrtarit ligjor z. Avni Bytyqi.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet

Pika 4. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën Janar-Qershor 2022;

Avni Bytyqi - e elaboron këtë pikë e cila ka të bëjë me çështjen e sigurisë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Aprovohet

Pika 5. Të ndryshme

Nazim Shabanaj - duhet të punësohen komunitetet. Kemi me fakultet dhe janë të papunë.

Denis Sofra - fillimisht duhet të paraqitet kërkesa për punësim. Tash ka ndryshu procedura e konkurseve. Kërkojmë përkrahje institucionale. Presim shifra për të rinjë.

Xheladin Sadikaj - për institucione publike mund ta gjejmë numrin e të punësuarve.

Takimi përfundoi: 14:15